



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1829/6 prot.

Datë 21.10.2021

V E N D I M
Nr. 787/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-02204-08-03-2021 me objekt “*Blerje Tonera*”, me fond limit 1,958,427 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Shkodër
Adresa: Rr. “Kolë Heqimi”, 11, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.08.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-02204-08-03-2021 me objekt “Blerje Tonera”, me fond limit 1,958,427 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

II.2. Në datën 22.09.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------------|
| 1. “Infosoft Office” SHPK | 1,137,535 lekë pa TVSH, skualifikuar; |
| 2. “Interlogistic” SHPK | 1,176,835 lekë pa TVSH, skualifikuar; |

II.3. Në datën 22.09.2021, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si më poshtë:

“1.OE ka paraqitur mostrat në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Spitalit Rajonal Shkodër ku mungon etiketa mbi ambalazh me të dhënat e mëposhtme:

- *Emri i produktit,*
- *Emri i markës prodhuese/ose ekuivalente*
- *Pulla e sigurisë*
- *Specifikimet e kërkuara.*
- *Treguesit kryesor fiziko-kimik*

duke qenë se është kriter i kërkuar në DST dhe operatori ka deklaruar që do të përmbushë çdo kriter të përcaktuar.”

II.4. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit në SPE në datën 24.09.2021.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 29.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton, se në datën 30.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1829/2 prot, datë 30.09.2021, u publikuan arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 2225/4 prot, datë 05.10.2021 protokolluar me tonën me nr. 1829/3 prot datë 07.10.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën.

II.9. Me anë të shkresës nr. 1829/4 prot. datë 11.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga autoriteti kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK shoqëruar me procesverbalin përkatës, si dhe informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për depozitimin e ankesës apo pretendimeve nga subjektet e interesuara pranë autoritetit kontraktor dhe trajtimin e tyre, apo çdo dokumentacion tjetër, në përputhje me përcaktimet e nenit 115 të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”

II.10. Me shkresën nr. 2348/1 prot, datë 15.10.2021 protokolluar me tonën me nr. 1829/5 prot datë 15.10.2021, autoriteti kontraktor ka paraqitur dokumentacionin dhe mostrat e kërkuara nga Komisioni i Prokurimit Publik.

II.11. Nga verifikimet e kryera rezulton se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: *“1.OE ka paraqitur mostrat në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Spitalit Rajonal Shkodër ku mungon etiketa mbi ambalazh me të dhënat e mëposhtme:*

- *Emri i produktit,*
- *Emri i markës prodhuese/ose ekuivalente*
- *Pulla e sigurisë*
- *Specifikimet e kërkuara.*
- *Treguesit kryesor fiziko-kimik*

duke qenë se është”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, pika 2.3.3 *“Kapaciteti teknik”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

“2.3.3. OE duhet të paraqesin:

- *Mostrat në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Spitalit Rajonal Shkodër.*
- *Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:*
 - *Emri i produktit,*
 - *Emri i markës prodhuese/ose ekuivalente*
 - *Pulla e sigurisë*
 - *Specifikimet e kërkuara.*
 - *Treguesit kryesor fiziko-kimik*
- *Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara”*

III.1.2. Me anë të shtojcës për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm si më poshtë:

“ISHTE

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

PIKA 2.3.3 OE duhet të paraqesin:

-Mostrat në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Spitalit Rajonal Shkoderë.

-Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- *Emri i produktit,*
- *Emri i markës prodhuese/ose ekuivalente*
- *Pulla e sigurisë*
- *Specifikimet e kërkuara.*
- *Treguesit kryesor fiziko-kimik*

-Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara

Bëhet:

PIKA 2.3.3 OE duhet të paraqesin:

Në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Spitalit Rajonal Shkoderë

Vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, më përdorueshmëri më të lartë për institucionin Perkatësisht

Artikulli

3	HP LaserJet M2727nf	Q7553A / HP 53
5	HP LaserJet M2727nf	HP 80x (CF280x)

8	HP LaserJet Pro MFP M521dn	CE255A
9	Samsung ML-1665	MLT-D1042S
10	Xerox B1022	006R01731
11	Xerox VersaLink B7030	20
12	Xerox Eork Centre 3025	106R03048

me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

-Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- Emri i produktit,
- Emri i markës prodhuese/ose ekuivalente
- Pulla e sigurisë
- Specifikimet e kërkuara.

Treguesit kryesor fiziko-kimik”

III.1.3. Në shtojcën 5 “Specifikime teknike”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit obehjt ankimi është përcaktuar si më poshtë:

“Bojëra printeri & fotokopje”

a)Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datasheet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.

b)Part-Numberi ndodhet ne datasheet-et apo katalogët e produkteve nga prodhuesi i pajisjeve, i cili duhet te përkojë me Part-Number qe gjendet ne çdo boje/toner.

c)Tonerat për printera dhe fotokopje duhet të jenë origjinale të prodhuesit të pajisjeve ose ekuivalente.

d)Tonerat do të jenë bojëra origjinale ose ekuivalentë të tyre, me vulë origjinaliteti, NUK DUHET te jene tonera kompatibel, te ricikluara apo të rimbushura.

e)Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit ”Genuine”.

f)Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre, jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit.

•Ambalazhimi të jetë në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.

•Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë së produktit.

•Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të markueshëm e të etiketueshëm, të hapen kollaj, të kenë volume të përshtatshme përdorimi dhe etikë në paraqitje.

•Duhet të lexohen me vëmendje rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.

•Në brendësi toneri duhet të ketë të gjitha pjesët mbrojtëse (plastiken mbrojtëse të drum-it, shiritin plastik të pluhurit, kapëset mbrojtëse, etj.)

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

•Emri i produktit,

•Emri i markës prodhuese/ose ekuivalente

•Pulla e sigurisë

•Specifikimet e kërkuara.

•Treguesit kryesor fiziko-kimik

Shënim: Tonerat për printera dhe fotokopje duhet të jenë origjinale të prodhuesit të pajisjeve ose/ ekuivalente, përdorimi i termit ekuivalent është vendosur pe te mos shmangur prodhues te tjere qe ofrojne tonera ekuivalente me origjinalin, tonera jo kompatibel, jo te ricikluara jo të rimbushura. Përdorimi i vetem i termit Tonerat për printera dhe fotokopje duhet të jenë origjinale të çon vetem tek prodhuesi i pajisjes , per te cilat kerkohen tonerat duke kufizuar pjesemarrjen dhe konkurrencen per prodhues te tjere qe ofrojne tonera ekuivalente me origjinalin ne kete procedurë prokurimi.”

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.6. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me shërbimet objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit, si dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave.

III.1.8. Nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, Komisioni konstaton, se ky i fundit ka paraqitur mostra të tonerave origjinale,

të cilat janë të prodhuara nga vetë prodhuesi i printerëve për të cilat do të përdoren. Gjithashtu, konstatohet se tonerat janë të pahapur, si dhe në kutitë e tyre konstatohet lehtësisht emri i prodhuesit, emri i produktit, numri i serisë, si dhe pulla e sigurisë. KPP gjykon se me anë të kërkesës së mësipërme, autoritetit kontraktor kërkon nga ana e operatorëve ekonomikë vendosjen e etiketës me qëllim që të jenë lehtësisht të verifikueshme të dhënat teknike të produkteve të ofruara të dhëna që lidhen me emrin e produktit, markën prodhuese, specifikimet teknike të kërkuara, treguesit fiziko kimik, të cilat në thelb vërtetojnë përputhshmërinë e produktit objekt prokurimi me kërkesat e autoritetit kontraktor. Por, Komisioni gjykon se mënyra si pasqyrohen të dhënat e produktit është në diskrecion të vetë prodhuesit dhe jo të ofertuesve pjesëmarrës në procedurë. Komisioni thekson se për autoritetin kontraktor duhet të jetë e rëndësishme të sigurohet që produktet e ofruara plotësojnë specifikimet teknike dhe jo ku pasqyrohen ato. Prodhues të ndryshëm, elementët e kërkuar lidhur me produktin, mund ti kenë të pasqyruara në trupin e produktit dhe jo domosdoshmërisht në ambalazhin e tyre. Në këto kushte, Komisioni gjykon se vendosja e etiketës mbi kuti apo mbi produkt nuk është kusht skualifikues, pasi qëllimi përfundimtar i këtij kriteri është njohja e të dhënave të produktit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-02204-08-03-2021 me objekt “Blerje Tонера”, me fond limit 1,958,427 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro